

Matteo Mandalà

Për botimin e veprës letrare të Françesk Anton Santorit

*Disa probleme ekdotike parafrake **

1.– *Parashtrësë*

Korpusi letrar i pabotuar i shkrimtarit arbëresh Françesk Anton Santori paraqet shumë probleme që presin zgjidhje. Duke lënë mënjanë çështjen e autorësisë që mund të themi se nuk paraqet vështirësi për t'u zgjidhur¹, po përmendim ato më kryesoret. Synimi është të tërhiqet vëmendja, nga njëra anë, e ilologëve mbi nevojën e përgatitjes së një botimi “kombëtar” të veprës së plotë letrare të Santorit edhe në hullinë e modelit të botimit të veprave të Zef Skiroit dhe të Jeronim de Radës, nga ana tjetër, e historianëve të letërsisë mbi nevojën e studimit të thelluar të kësaj vepre letrare, e cila mund të themi pa hije dyshimi se është më e larmishmja dhe më e pasura e gjithë periudhës së Rilindjes. S'ka dyshim se pa angazhimin e të parëve, përpjekjet e të dytëve do të ishin të kota, duke dëmtuar kështu njohjen e vetë zhvillimit historik të letërsisë shqipe.

Problemi i parë ka të bëjë me kalimet e dorëshkrimeve dorë më dorë pas vdekjes së autorit, identitë ikimin dhe klasi ikimin e tyre. Përveç disa të dhënave të pjesshme në studimet dhe tek-

* Botuar në revistën *Hylli i Dritës*, anno XXXI, janar-shkurt-mars 2011, nr. 1(anno XXXI, janar-shkurt-mars 2011, nr. 1), 51-78; Ribotuar në Matteo Mandalà, *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe*, Naimi, Tiranë, 2012, f. 149-180.

¹ Mjeti më i shpejtë përbëhet nga gra ia e veçantë e Santorit, që na lejon t'ia njohim atij autorësinë e dorëshkrimeve që nuk kanë emër autori. Një mjet tjetër i sigurt janë vetë alfabetet e Santorit: për më tej shih Francesco Altimari, *Un saggio inedito di F. A. Santori sulla lingua albanese e i suoi alfabeti*, Quaderni di *Zjarri*, vol. 7, (San Demetrio Corone), Cosenza, 1982.

stet kritike të veprave të pabotuara të Santorit², askush nuk është marrë seriozisht me këtë çështje.

Përjashtim bën studimi i gjerë që botoi disa vjet më parë Giuseppe Gradilone³, ku jepte të dhëna të hollësishme mbi «të gjitha dorëshkrimet e veprave të Santorit» që gjenden «në biblio-

² Shih Francesco Antonio Santori, *Il Canzoniere Albanese*, a cura di Francesco Solano, Corigliano Calabro, 1975; Francesco Antonio Santori, *Brisandì Lletisja e Ulladbeni*, transkriptimi i tekstit origjinal të pabotuar dhe ndryshimet e redaktimit të parë me një hyrje dhe një fjalorth nga Ital Kostant Fortino, Cosenza, 1977; Francesco Antonio Santori, *Panaini e Dellja - Fëmija pushterjote*, editio princeps, prolegomeni, trascrizione e apparato critico a cura di Giuseppe Gradilone, Bulzoni editore, Roma, 1979; Francesco Antonio Santori, *Alessio Ducagino*, Melodramma, Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura di Francesco Solano, Castrovillari, 1983; Francesco Antonio Santori, *Tre novelle*, Prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Italo Costante Fortino, Carmine Stamile, Ernesto Tocci, Cosenza, 1985. Francesco Antonio Santori, *Satira*, Translitteruar dhe pajisur me shënime nga Karmell Kandreva dhe Gjovalin Shkurtaç, Shtëpia Botuese Dituria, Tirana, 1998. Francesco Antonio Santori, *Neomenia: tragedia e parë në gjuhën shqipe*, prefazione di Anton Nikë Berisha, Prishtinë, Shpresa, 2001. Si aggiungano le tesi di laurea discusse presso l'Università della Calabria (Vincenzo Frazzinguaro, "Fëmija Pushterjote" *Novella in versi di Francesco Antonio Santori*, relatore prof. Francesco Solano, a. a. 1979-80; Rosanna Guagliardi, *Due versioni inedite del "Canzoniere" di Francesco Antonio Santori*, relatore prof. Francesco Altimari, a. a. 1993-94; Tiziana Misasi, *Il testo di un melodramma inedito di Francesco Antonio Santori: "Pjetër Shtërori"*, *Trascrizione, traduzione, analisi e concordanza*, relatore prof. Francesco Altimari, a. a. 1995-96; Anna Sabina Ragusa, *Il testo di un melodramma inedito di Francesco Antonio Santori: "Miloshini e Pjetroshini"*, relatore prof. Francesco Altimari, a. a. 1995-96; Daniela Meringolo, *La "Neomenia" di Francesco Antonio Santori: introduzione, edizione critica e concordanza*, relatore prof. Francesco Altimari, a. a. 2001-02; Sandra Domanico, *Le favole tradotte in albanese da Francesco Antonio Santori: introduzione, trascrizione e traduzione*, relatore prof. Francesco Altimari, a. a. 2004-05; Luigi Genise, "Krështeu i shjëtuer" *di Francesco Antonio Santori: edizione critica e traduzione italiana*, relatore prof. Francesco Altimari, a. a. 2004-05; Saverina Bavasso, *Edizione critica del manoscritto "Mbë kënkëka vallesh" di Francesco Antonio Santori*, relatore prof. Francesco Altimari, a. a. 2007-08) e presso l'Università di Palermo (Giovanna Cerniglia, *Le Kalimere di Francesco Antonio Santori: edizione critica*, relatore prof. Matteo Mandalà, a. a. 2006-07; Mimma Capaci, *Il manoscritto inedito di Francesco Antonio Santori: "Melodram Alhbyresh" Premessa a un'edizione critica (introduzione e testo critico)*, relatore prof. Gëzim Gurga, a.a. 2009-2010).

³ Shih Giuseppe Gradilone, "Francesco Antonio Santori. Un romantico fra tradizione e realismo" në Giuseppe Gradilone, *Altri studi di letteratura albanese*, Studi Albanesi pubblicati dall'Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma sotto la direzione del prof. Ernesto Koliqi, vol. VI, Bulzoni, Roma, 1974, f. 7-77.

tekën e qytetit të Kozencës»⁴. Asokohe këto dorëshkrime «ende nuk ishin kataloguar e si pasojë nuk e kishin një pozicion të caktuar; ishin ndarë përkohësisht në tri pako me mbishkrimin: “Manoscritti delle opere del Santori” dhe ndonjë numër thjesht orientues»⁵.

Më poshtë do të rikthehemi në këtë aspekt, por tani le të shqyrtojmë të dhënat që kanë të bëjnë me atë që Gradilone e quajti «aventura e pelegrinazheve» të këtyre dorëshkrimeve:

«Dorëshkrimet, para se të përfundonin aty ku janë sot, gjatë luftës së fundit janë endur në pelegrinazhe të ndryshme brenda dy arkave ku bashkë me to gjendeshin edhe veprat e botuara e të pabotuara të De Radës, që u hoqën nga Akademia Italiane»⁶.

Nëse deri më sot dihet arsyeja pse disa dorëshkrime të Santorit dhe të De Radës në një çast të dhënë të historisë së tyre ndoqën një rrugë të ndryshme nga ajo e dorëshkrimeve që ruhen në bibliotekën e qytetit të Kozencës, nuk kuptohet se si dorëshkrimet e Santorit përfunduan në të njëjtat arka me ato të De Radës, para se të shpërndaheshin nëpër biblioteka të tjera brenda dhe jashtë Italisë.

2.— *Odiseja santoriane*

Shpjegimi gjendet në testamentin autograf që ruhet në *Theca* V.26 të fondit *Albansk Samling* të Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës:

«Tutti i manoscritti italiani saranno dello stesso finamante Santori. I manoscritti albanesi dovranno mandarsi a D. Giovanni Stamile di S. Giacomo, per farli capitare a D. Girolamo De Rada in Macchia»⁷.

⁴ Po aty, f. 9 shën. 4.

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

⁷ *Albansk Samling*, Theca V.26, “Fragmentum testamenti italice, scripti ab Antonio Santorio poeta”, f. 1v. Ndryshon pak emërtimi që jep Gangale në artikullin *Verzeichniss zur*

S'ka dyshim se Giovanni Stamile që përmendet këtu është po ai që Santori zgjodhi si pasardhës në krye të famullisë që në vitin 1874 i kishte besuar Livio Parlatore, peshkop në San Marco Argentano. Giovanni Francesco Stamile (San Giacomo di Cerzeto 1820) ishte një intelektual dhe politikan liberal që mori pjesë me entuziazëm në revolucionin e dështuar të vitit 1848 që ngjalli shpresa të mëdha edhe tek vetë Santori (lindur në fshatin arbëresh Picilie më 16 shtator 1819), dhe u bë burim frymëzimi për veprën *Il prigioniero Politico*⁸. Vendimi i Santorit ishte i goditur, pasi bashkëpunëtori që kishte zgjedhur ishte mik i ngushtë i Jeronim De Radës, madje ishte bërë edhe kumbarë i tij⁹.

Zhvendosja e dorëshkrimeve do të jetë kryer pas vdekjes së Santorit, më 7 shtator 1894 në San Giacomo di Cerzeto. Nuk e dimë për sa dhe për cilat dorëshkrime bëhej fjalë, e nuk dimë as se ç'rrugë ndoqën tekstet që Santori i dalloj nga ato "italiane" duke i quajtur "arbëreshe", pasi mbërritën në destinacionin që u kishte caktuar autori. Nuk jemi as në gjendje të themi nëse "të gjitha" dorëshkrimet mbërritën në shtëpinë e De Radës apo, siç mund të merret me mend, disa syresh ndoqën një rrugë të ndryshme nga ajo që donte autori.

Për sa u përket dorëshkrimeve "arbëreshe", sipas të dhënave që mund të nxjerrim *a posteriori*, ka të ngjarë që mes atyre që iu dërguan De Radës të ishin edhe ato që sot ruhen në fondin e lartpërmendur *Albanisk Samling* pranë Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës. Ka të ngjarë gjithashtu që ato dorëshkrime të

Albanischen Handschriftensammlung Kopenhagen, në *Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck* 1972, zum Gedächtnis an NORBERT JOKL, Herausgegeben von Hermann M. Ölberg, Innsbruck, 1977, f. 611: "Theca V.26 Piesa dhiatesy e Santorit. Fragmentum testamenti ab Antonio Santorio poeta Italice scripti".

⁸ Shih Francesco Antonio Santori, "Lettera a Giovanfrancesco Stamile" në Francesco Antonio Santori, *Il prigioniero politico*, Napoli, 1848, f. 69-71.

⁹ Të dhënat mbi Stamilen i kam marrë nga siti i sportelit gjuhësor të fshatit San Giacomo di Cerzeto, përgatitur nga Sandra Domanico dhe Olga Dolce: www.comune.cerzeto.cs.it/it/la-storia-e-i-personaggi/12-artisti-e-letterati. Me këtë rast falënderoj Sandra Domanico-n për bashkëpunimin e frytshëm.

kishin rënë në duar të ndryshme, ndoshta familjarë e pasardhës të Santorit, të cilët më pas ia kaluan drejtpërdrejt a tërthorazi Gangales.

Për sqarimin e kësaj çështjeje na vijnë në ndihmë të dhënat që na la vetë Gangale mbi udhëtimet e shumta që kreu në Itali,¹⁰ ku mblodhi shumë dorëshkrime nëpër viset arbëreshe të Italisë së Jugut, sidomos në Kalabri dhe në Sicili.

Gangale mund t'i ketë mbledhur dorëshkrimet gjatë dy udhëtimeve të para që kreu përkatësisht në maj të vitit 1956 dhe nga 2 dhjetori 1956 në 4 janar 1957 në Maqi¹¹. Gjithsesi nuk përjashtohet që gjatë tetë udhëtimeve të tjera që kreu në Sicili (Hora e Arbëreshëve, Contessa Entellina dhe Palazzo Adriano) Gangale të mos ketë kaluar nga Kalabria për të vijuar kërkimet nëpër arkivat privatë. Në fakt në shënimet e tij i dërguari i gjuhëtarit të shquar Louis Trolle Hjelmslev, që pasoi albanologun Holger Pedersen në krye të katedrës së gjuhësisë të Universitetit të Kopenhagës, shkruan se «një pjesë e mirë e dorëshkrimeve të tij [të Santorit] gjendet në bibliotekën e qytetit të Kozencës» («*Ein guter Teil seiner*

¹⁰ Shih *Albanske håndskrifter erhvervet af dr. G. Gangale i Italien 1956*, regjistër dorëshkrim që ruhet pranë Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës.

¹¹ Këto të dhëna janë nxjerrë nga dorëshkrimi që mban titullin: “Albanske håndskrifter erhvervet af dr. G. Gangale i Italien” (Dorëshkrime shqipe të mbledhura nga dr. G. Gangale në Itali). I të njëjtit mendim ishte edhe Arshi Pipa, i vetmi studiues që ka shfrytëzuar dokumentet e pabotuara mbi udhëtimet e Gangales në Itali: «The manuscripts constituting tje Albanian Collection are in the process of being catalogued. The following is a description based on an official listing of the acquisitions ad collections made by Dr. Giuseppe Gangale during eleven journeys to Italy from 1956 to 1968»: në të vërtetë, sipas shënimeve që gjeta në Kopenhagë, Gangale i përfundoi kërkimet për llogari të Institutit të gjuhësisë daneze në vitin 1960 (nga 2 deri në 17 janar). Më i saktë është Pipa kur përmend udhëtimet në Maqi që përfunduan me marrjen e dorëshkrimeve të De Radës: «[...] I. De Rada's manuscripts in the “Albansk Samling” (“Rejse I”, May 1956, and Rejse II”, Dec. 2, 1956 – Jan. 4, 1957)...»: Arshi Pipa, “The Odyssey of De Rada's Manuscripts”, në *Përpyekja e Jonë*, n. 4. 1972, f. 12-13. Mbi ditaret e udhëtimeve të Gangales shih kumtesën time “*L'Albanske Samling della Biblioteca Reale di Copenaghen*” në *Biblos*. Servizio di informazione culturale e bibliografico della biblioteca comunale “G. Schirò” di Piana degli Albanesi, anno X, nn. 23-24, Palermo, 2003, f. 51-57.

*Handschriften liegt in der Biblioteca Civica von Cosenz^a)*¹², duke na konfirmuar kështu se ai e dinte mirë se ku ruheshin këto vepra të letërsisë arbëreshe. Për më tepër Gangale nuk e fshehu synimin për të blerë, nëse pronarët do t’ia shisnin, dy dorëshkrime të pabotuara të Santorit që ishin në pronësi të disa arbëreshëve nga San Giacomo (“*Einiges habe ich auch in Privathänden in S. Giacomo, einem albanischen Dorf, wo Santorius lange die Seelsorge betreute, gefunden aber noch nicht erwerben dürftem*”)¹³.

Ky fakt ka një vlerë të dyfishtë: nga njëra anë, meqenëse këto ndodhnin para nëntorit të vitit 1973 kur u shkruan shënimet, mund të themi me siguri se Gangale u referohej dorëshkrimeve që deri atëherë, ende *nuk* ishin futur në fondin danez, por kishin mbetur në duart e pronarëve të tyre. Nga ana tjetër, dëshmohej se dorëshkrimet që sot ruhen në *Albanske Samling* jo vetëm që u blenë nga Gangale gjatë udhëtimeve të tij, por nuk kishin të bënin me ato që ruheshin në bibliotekën e qytetit të Kozencës, të cilat vinin drejtpërdrejt nga shtëpia e Jeronim De Radës. Këtë pohim të fundit e dëshmojnë shënimet e mëposhtme që Gangale shkroi me makinë shkrimi në dy nga tre fashikujt që përbëjnë dosjen *Theca* III.17, mbi të cilën do të kthehemi më poshtë. Shënimi i parë që gjendet në fash. α – «Repperi domi Radhae?» –, shpreh njëfarë dyshimi të Gangales, ndërsa shënimi i dytë që ndjek titullin e fash. β – «Domi poetae Radhae repertum» –, dëshmon me siguri se së paku një pjesë e dorëshkrimeve të Santorit që ruhen në *Albanske Samling*, pikërisht ato që përfshihen në dy fashikujt e parë të dosjes *Theca* III.17, vijnë nga një fond që u përkiste trashëgimtarëve të De Radës. Ky fond ishte i ndryshëm nga ai që, pasi u mblodh në dy arka, u ble nga Akademia italiane në vi-

¹² Giuseppe Gangale, *Kommentare zur Albanischen Handschriftensammlung Kopenhagen* (5.XI.1973), version i daktilografuar që ruhet në Bibliotekën Humanistike të Universitetit të Kalabrisë: *ad vocem*, *Theca* III.5 “Antonius Santorius, Carmina”.

¹³ “Un paio [di manoscritti] sono in mano a privati di S. Giacomo, un villaggio albanese dove Santori ha amministrato a lungo la cura pastorale, ma non ho ancora il permesso di acquistarli”: Po aty.

tin 1943 e u dërgua në Romë dhe Firenze, u kthye i përgjysmuar në një arkë të vetme në Kalabri për t'u ruajtur në bibliotekën e qytetit të Kozencës¹⁴.

3.– *Korpusi danez i dorëshkrimeve*

Gjendja e sotme e shpërndarjes së detyruar të veprave të Santorit ndahet në dy degë: njëra “publike” e tjetra “private”. Dega e parë përfaqësohet nga tri entet ku ruhen veprat më të rëndësishme: Biblioteka e qytetit të Kozencës, Biblioteka Mbretërore e Kopenhagës dhe Arkivi i Shtetit në Tiranë. Ky i fundit, së bashku me dorëshkrimet e De Radës që iu dhuruan gjatë pushtimit fashist të Shqipërisë, ruan edhe disa dorëshkrime të Santorit. Vetëkuptohet se puna hulumtuese që duhet kryer mbi këto dorëshkrime do të ishte e thjeshtë sikur të mos ndeshte në vështirësitë që zumë ngoje në krye të këtij punimi.

Duke lënë mënjanë përkohësisht dorëshkrimet që ruhen në Kozencë dhe në Tiranë, do të ndalemi në shqyrtimin e hollësishtëm të dorëshkrimeve që gjetëm në vitet 2003 dhe 2007 në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagës.

Në vijim, përveç të dhënave të shkurtra që na ka lënë Gangale mbi lëndën e përmbledhur në tri dosje (Theca) të fondit *Albanske Samling* në punimin *Verzeichnis* që botoi në vitin 1977 (por që e kishte shkruar katër vite më parë), do të kufizohemi në përshkrimin fizik të dorëshkrimeve me synimin për të nxjerrë syresh të dhëna të dobishme për zgjidhjen e një problemi të vështirë ekdotik që parashtron korpusi dorëshkrim i veprave të Santorit: problemi i datimit të teksteve, që me gjasa u shkruan disa herë në kohë të ndryshme.

1) Theca III.5

Emërtuar nga Gangale «Ntoni i Santorit. Konka – Antonius Santorius. Carmina»¹⁵, kjo dosje përfshin disa fashikuj, që Gangale

¹⁴ Shih Arshi Pipa, “The Odyssey of De Rada’s Manuscripts”, cit, f. 9-12.

¹⁵ Giuseppe Gangale, *Verzeichnis*, cit., f. 605“.

i analizoi dhe klasifikoi më tej. Po e risjellim më poshtë këtë klasifikim, ku për të lehtësuar identifikimin kemi shtuar germat e alfabetit grek:

III.5.α Fletore me format 12,5 × 17,5 cm. me 28 fl., me numërtim arab progresiv joautograf shkruar mbi marginën e sipërme, djathtas. Fillimisht Gangale e emërtoi tekstin «“Episo-Evangeli” versibus Arberiscis narrata, inter ea carmina amatoria...». Mirëpo më pas, duke synuar të dallonte më qartë dy pjesët përbërëse, e riemërtoi me dy tituj të ndryshëm: «Cetera carmina amatoria Santorii» dhe «Calimera passionis ab eodem scripta», të cilat për lehtësi paraqitjeje po i shënojmë me dy sigla përkatëse: III.5.α1 dhe III.5.α2.

Teksti i pjesës së parë ndahet më tej në katër pjesë me nëntitullin e përgjithshëm autograf në shqip <Cynycy> ‘Kënkë’, që fillojnë këto vargje:

- fl. 1: <O bubukke barde e cukke> ‘O bubuqe bardhë e kuqe’ vv. 1-35
fl. 2: <Jo myy, jo myy te zhymyra> ‘Jo më, jo më te zëmëra’ vv. 1-42
fl. 4: <Popo ! Vash sa e buccur jee> ‘Popo ! Vash sa e bukur jë’ vv. 1-52
fl. 6: <O ju çy chinni zhymyryn ty gnomy> ‘O ju çë kini zëmëren të njomë’ vv. 1-12

141 vargjet e katër këngëve, sikurse kuptohet edhe nga vargjet e mësipërme, kanë karakter erotik. Ato konfirmojnë ndjeshmërinë laike dhe aftësinë e jashtëzakonshme të Santorit për t’i kënduar dashurisë.

Pjesa e dytë përfshin një këngë të gjatë me 598 vargje me titullin shqip <Darcha> ‘Darka’, ku Santori, duke rievokuar Darkën e Fundit, i këndon misterit të pasionit dhe të vdekjes së Jezu Krishtit.

Koherenca e përmbajtjes dhe e stilit të këtyre dy pjesëve na bën të mendojmë se Santori kishte ndërmend ta përfundonte shkrimin e tyre dhe se kështu siç na kanë mbërritur ato përfaqësojnë vetëm një fazë të ndërmjetme të punës. Të dyja pjesët janë shkruar në së paku tri faza. Faza e parë, nga e cila nuk na ka mbërritur asgjë, ka qenë ajo e shkrimit në dorë të parë, ndërsa

faza e dytë që përfaqësohet pikërisht nga fashikulli në fjalë, ishte një fazë rikopjimi: këtë e dëshmon shkrimi i dorës dhe sidomos shtimi i numrit të rreshtave të shkruara në çdo fletë¹⁶. Ndrejjet dhe shtesat mes rreshtash dhe anash faqeve që përmban ky tekst parakuptojnë një fazë tjetër rishikimi të një varianti përfundimtar, nga i cili nuk na ka mbetur gjurmë.

Përmbajtja e dy pjesëve dëshmon se ato ishin të pavarura, çka përlligj zgjedhjen e Gangales për t'i vënë nga një titull të veçantë secilës prej tyre.

III.5.β Gangale nuk i vuri titull kësaj fletoreje me format të madh (cm. 18,5 × 27) me gjithsej 43 fletë, që mban një numërtim progresiv joautograf shkruar me laps. Arsyeja e mungesës së një emërtimi qëndron në natyrën heretogjene të teksteve që përmban kjo fletore, të cilën Santori e përdori për të shkruar pjesë sprovash të ndryshme të veprave të tij. Këtë e dëshmon shkrimi i dorës që ndryshon hera-herës. Në këtë dorëshkrim dallojmë katër seksione të ndryshme, që po i emërtojmë në vijim duke i shtuar siglës nga një numër arab. Meqenëse fl. 1v, duke qenë e bardhë, nuk është numërtuar, kemi dalluar faqet në “r(ecto)” dhe në “v(erso)”.

β.1: fl. 1r këngë e gjatë me 36 vargje pa titull, që fillon me vargun: <Mbjidemi trima, mbjidemi bascq> “Mbjidhemi trima, mbjidhemi bashk”. Anash faqes, tërthoras me tekstin kryesor, janë shtuar dy pjesë me 15 vargje që janë vazhdim i këngës. Vihet re vetëm një ndërhyrje ndreqëse mes rreshtash. Një pjesë me 8 vargje të tjera është shkruar në fl. 1v, në margjinën e djathtë të fletës.

β.2: fl. 2r-3v. Ka një tekst që mban titullin autograf në shqip <Qummeddie> “Kumedje”, që paraprihet nga një listë me personazhet e një vepre teatrale. Teksti në shqip është shkruar në një kolonë në anën e majtë të fletëve, çka parakupton se Santori kishte ndër mend të shtonte djathtas përkthimin italisht. Në fl. 2v autori ka shënuar disa llogarit aritmetike.

¹⁶ Në fl. 7-20 numri i vargjeve luhetet nga 24 në 26, fleta 20 përmban 27 vargje, ndërsa fletët që vijojnë përmbajnë 32-34 vargje.

β.3: fl. 3v-15r. Këngët e shkruara në këtë pjesë të fletores përfaqësojnë fazën e parë të shkrimit të përmbledhjes “rapsodi popullore arbëreshe” (shih *infra*, fash. γ, *Theca* III.17). Tekstet janë shkruar në dy kolona dhe janë kryesisht pa përkthim italisht. Vihen re fshirje dhe ndreqje brenda rreshtit dhe mes rreshtave, si edhe shtesa vargjesh anash faqeve. Numërtimi i fletëve është i parregullt: ndërpritet në nr. 11 (fl. 5v), rifillon po aty nga nr. 16 në nr. 21 (fl. 6v) dhe vijon nga nr. 23 në nr. 25 (fl. 7v). Nga fl. 8v në fl. 9v vijon shkrimi i gjashtë këngëve, nga të cilat e para është pa titull, ndësa pesë të tjerat mbajnë titullin e përgjithshëm italisht <Canto>. Një këngë tjetër që është shkruar po në fl. 9v mban numrin 42, ndërsa katër këngët që gjenden në fl. 11r, 11v dhe në pjesën e parë të kolonës A të fl. 12r janë pa titull. Shënojmë se e para nga dy këngët e fl. 11r u shkrua nga Santori jo për t’u përfshirë në rapsoditë popullore: këtë e dëshmon subjekti fetar dhe struktura metrike e formale e këngës, me vargje të rimuara tetërrokëshe dhe strofa katër vargëshe. Nga mesi i fl. 12r vijojejnë 12 këngë, nga të cilat njëmbëdhjetë të parat janë numërtuar me nr. 52-61 (fl. 14v), ndërsa e fundit është pa numër. Mund të themi se këto tekste përfaqësojnë një fazë të ndërmjetme shkrimi që do të pasohet nga faza e rikopjimit që dëshmohet nga dorëshkrimi i fash. γ, *Theca* III.17. Këtë e dëshmojnë dy shënime: i pari në italisht në fund të këngës 11 (fl. 5v), që përmban incipitet e këngëve të para të shkruara si edhe ato që duhej të vijonin. Shënimi i dytë (fl. 10r-v), thujse i tëri në shqip, përmban incipitet e këngëve që Santori duhej të shtonte, pra ato nga nr. 1 deri në nr. 31 si edhe të pesëdhjetë këngëve të tjera të panumërtuara. Rëndësi të posaçme paraqet ky pasazh:

«Dietro questa canzone [la nr. 11] si pone il carme nuziale. Quindi il Canto “Qusc m’e byri triesyn” ecc. Poscia l’altro augurale sull’affetto del matrimonio “Mori vasc je barda vasc” ecc. 64. Dappoi i lavori domestici cui si adatta Biancavite e il suo ricamo “Malhet e Pietyr Sctyrôrit” modificata 18; in prosieguo le prima avventura del nuoto di “Qiparisso Ghiθ suvalha i nzuori mb’aan” 22. Seconda avventura “Vuun quscit trimi Fanymüir” ecc. 39. Il Resentim[ent]o malinconico “Vieen marsi, müir se vieèn”, 37. Canto I. p. 69 “Gara di Biancavite” con una canzone da farsi sull’ampia prolificaz[ion]e di Qiparisso

e Biancavite. *Tentato rapimento* Morte di Qiparisso ferito da turchi, che tentano le prime scorrerie. Figli di Biancavite Didescura, Pietro Storti, Radavane, Miloscino, Mistriato [Ajò Zhogna 79], Pietroschino, *Tentato rapimento* di Biancavite per opera di Alibeq “Bÿri qysciil Alibeqqu”...»

Shënimet mbi shpërndarjen dhe rendin e lëndës dëshmojnë se Santori synonte t’i jepte veprës një strukturë që duhej të përfaqësonte në mënyrë organike “Poemën” e madhe kombëtare shqiptare, atë “Kalevala” arbëreshe që asokohe rrekeshin ta krijonin edhe Jeronim De Rada e Nicolò Jenò de’ Coronei. Tashmë është e qartë – e do të bëhet edhe më e qartë kur të përshkruhet fash. γ.3a, *Theca* III.17 –, se nevojës për të ballafaquar lekcionet e këtyre këngëve me ato të botuara në vitin 1866 i shtohet edhe kërshëria shkencore për të verifikuar se cili qe kontributi i Santorit dhe i intelektualëve të tjerë arbëreshë në realizimin e projektit madhështor të De Radës¹⁷. Kërshëria mbështetet edhe nga vetë pohimet e Santorit i cili na thotë se disa nga këto “këngë” nuk janë mbledhur “nga goja e popullit”, por janë krijime origjinale të tij. Para se të risjellim në vijim incipitet e këngëve, shënojmë se në dy faqe (fl. 18r-v) Santori shkruan në disa kolona dhe në rend alfabetik disa kombinime të pakuptueshme rrokjesh:

- | | | |
|-------|-------|-------------------------------|
| f. 3v | c. 1 | <Vej i biri i Fùghies> |
| | c. 2 | <Mbaj e yma ty mbuliir> |
| f. 4r | c. 3 | <Trimi biir ji Fùghies> |
| | c. 4 | <Quur u prùartin Fatàzhit> |
| | c. 5 | <Ajò Zhogca pizzzyvèerd> |
| f. 4v | c. 6 | <Byyj qysciil zhogna Lheen> |
| | c. 7 | <Lhuonej vàsicia me gny mool> |
| | c. 8 | <Venej trimi lhumit lhârt> |
| f. 5r | c. 9 | <Prirej trimi ji hejmùer> |
| | c. 10 | <Fyrsciylùen dhi Zhogce> |
| | c. 11 | <Dhalhur dhîeli málhescit> |

¹⁷ Shih Girolamo De Rada, *Rapsodie d’un poema albanese: raccolte nelle colonie del Napoletano tradotte da Girolamo De Rada e per cura di lui e di Niccolò Jenò de’ Coronei ordinate e messe in luce*, Tipografia Federico Bencini, Firenze, 1866.

- f. 5v c. 16 <Vieen Marsi miir se vieen>
 f. 6r c. 17 <Lhighyrojìn dhi qunàtta>
 c. 18 <Ndhy dhidièt scquora vièt>
 c. 19 <Qu biu, qu biu narynza?>
 f. 6v c. 20 <Alibèqqu i Rhumanii>
 c. 21 <Fyrsciylejin dhi zogca>
 c. 23 <Gkiθ suvalha nzuar ndhy zhaal>
 f. 7r c. 24 <Ndhy padeen ty málhevet>
 c. 25 <Vuri nqusct kparissi>
 f. 8v <Pienej j'atti bilhyzhit>
 <Sqepti dhieli ndh'attò malhe>
 f. 9r <Voguglhi biir i Fughies>
 <Ndhy gny dhit je verie>
 f. 9v c. 42 <My udissi árminòi>
 f. 11r <O Lhefteròr i gkiyθθvet>
 <Sciòkkia je Dheddi Squrys>
 f. 11v <Ghergk Qandrèva zilhi θuhhej>
 <Vascia quur uij zuu ty zhoon>
 f. 12r c. 52 <My kyloi kylòì gkumi>
 c. 53 <Dhil scqurturi Varròz>
 f. 12v c. 54 <My qyntòj qyntòj gny zogk>
 c. 55 <Ai Dhragutti c'isc qussàr>
 f. 13r c. 56 <Vascia ciy ty dasciurin>
 c. 57 <Udhygn lhugâd i gkat e i gkeer>
 f. 13v c. 58 <Isc gny j'ym e fanymiir>
 c. 59 <Pry ndhy hora t'Arbyriis>
 f. 14r c. 60 <Quur ciy koscia u mbulli>
 c. 61 <Tuqqe vattur udies>
 f. 14v c. 62 <Garantina e vèttymèzh>
 <Ndh'attò malhe ty Janninys>

β.4: fl. 15v. Dy këngë në arbërisht, të shkruara përkatësisht në gjysmën e parë të kolonave A dhe B të fletës. Kënga e parë përmban 26 vargje dhe mban titullin autograf <Strambòtèzh Pry | Ty rhimòssur ndhy qattundh | o gkettyq>. Kënga e dytë që numëron 21 vargje është pa titull, por njësoj si e para i këngon kremtimit të karnevaleve.

β.5: fl. 15v-22v. Kjo pjesë përmban skicën e veprave që Santori do t'i quajë *Kalimera*. Kemi të bëjmë me një variant pararendës

ndaj atij që ruhet në fash. III.5.δ. Këtë e dëshmojnë ndërhyrjet e shumta ndreqëse dhe sidomos shtesat, numërtimi i parregullt i *Kalimerave* të veçanta, si edhe mungesa thujse totale e titujve që gjejmë në variantin e dytë. Por mbi të gjitha e dëshmojnë ndryshimet e thella tekstore që vihen re mes variantit të parë dhe atij të dytë, ndryshime që nuk është vendi t'i analizojmë këtu. Gjithsesi kjo nuk na pengon të shprehim keqardhje për nxitimin që kanë treguar disa “filologë” të cilët i janë referuar këtij fashikulli e përgjithësisht atyre që përmban *Theca* III.5 sikur të kishin konsultuar vërtet origjinalet. Në fakt elementet që sjellin dëshmojnë pa hije dyshimi se ata nuk e njohin përbërjen e vërtetë të kësaj dosjeje. Sikur të mos ishte kështu, jo vetëm që nuk do të kishin cituar gabim pozicionin e disa teksteve të Santorit në fondin *Albanske Samling*, por nuk do t'i kishin ngatërruar me njëri-tjetrin duke dëmtuar kështu edhe ato pak të dhëna që u japin lexuesve¹⁸. Në vijim po kufizohemi të japim vetëm incipitet e *Kalimerave* të veçanta:

¹⁸ Le të sjellim këtu rastin e Italo Costante Fortino-s, njërit prej botuesve të disa veprave të Santorit. Në një artikull të parë Fortino kishte sjellë pozicionin e saktë që zinin në fondin *Albanske Samling* dorëshkrimet e Santorit, duke dhënë kështu përshtypjen se kishte punuar me origjinalet: «ricordo che varie sue [di Santori] opere sono catalogate nell'Albanian collection, Theca III.5; Theca III.17; Theca V.26 e Theca V.58. Precisamente nella Theca III.5 troviamo la “Redactio altera Calimerae dierum Dominicarum et Quaresimae a F. A. Santorio redactae” – l'indicazione è di chi ha ordinato il fascicolo...»: Italo Costante Fortino, “Le *Kalimere* di Francesco Antonio Santori”, botuar në Francesco Altimari et alii (a cura di), *Atti del congresso internazionale di studi sulla lingua, la storia e la cultura degli Albanesi d'Italia. Akten des Internationalen Kongresses für Sprache, Geschichte und Kultur der Albaner Italiens* (Mannheim, 25-26 giugno 1987), Studi e testi di albanistica 1, collana diretta da F. Altimari Università degli Studi della Calabria – Universität Mannheim, Centro Editoriale Librario dell'Università della Calabria, Rende 1991, f. 109-110. Mirëpo duke e rimarrë këtë çështje në hyrjen e botimit kritik të *Kalimerave*, çuditërisht Fortino “vetëndreqet” duke na dhënë një pozicion të ri të dorëshkrimeve, tashmë të gabuar: «Il fascicolo degli autografi delle *Kalimere* del Santori si trova nella Biblioteca Reale di Copenaghen, nel settore “Manoscritti” (Handschriftabteilungen – sic!), Albanian collection, Theca III.51...», duke saktësuar me një shënim se «nella mia relazione tenuta a Mannheim era riportata erroneamente la collocazione Theca III.5, mentre si deve leggere Theca III.51», e cila natyrisht nuk ekziston në fondin *Albanske Samling*: Italo Costante Fortino, “Le *Kalimere*. Prolegomeni

fl.	Titulli	Incipiti
15v	<Qalhimère>	<Nani ciy hittim na te qiò shpii>
16r	<Qalhimère Pry ty paryn ty dhìel ty Qrèscmyvet>	<Zhogna, bullhèer e zhottra mirhni vesc>
16v	<Qalhimère e 1°>	<Zyni me maal e mbamni pry signaal>
17r		<Dhiàli s'e ntjùgcòì sciybèssin dhrek>
17r		<Dhuoni t'e zyni ju ciy rhini atti>
17v	<III>	<Ndho se sciyrbisset ciy ty mira jaan>
18r	<IV>	<Po mirhna vesc, e zhogna niqokire>
18v		<Sa gkint iscin attiè gki u tramtaxtin>
18v		<Kiscia e Jerusalimit, madia kisc>
19v		<Anamèssa za timpa, ndhy za brigna>
20r		<Gny kinturiòn i kofciy e burh i miir>
20v	<Naimiòttia>	<Gny naimiotte gcrua, po qologrèe>
21r	<Dhyhìa e Dheetit>	<U nissytin me gn'anii e vaan mbi dheet>
21v	<Zhotti Qrisct Ngkalyn ty birin e Rhègolit>	<Ke ndhy Judèe gny zhot i Rhomytàs>
22r	<Viehyrha e S. Piètyrit>	<Piètyri qisc ty vièhyrhyn symuur>
22r	<Qriscti sciyròon gn'Idròpyq>	<Iesùssi ji nvitùor qagny prinkip>
22v	<Imyn>	<Doxa, lhaudim e ntèr>

per l'edizione critica" në Francesco Antonio Santori, *Le kalimere di Francesco Antonio Santori, Prolegomeni, trascrizione, apparato critico e concordanza*, Brenner, Cosenza, 2004, f. 9 dhe shën. 11. Kjo dukuri e çuditshme hiperkorrektizmi që shfaqet pas pesëmbëdhjetë vjetësh ka një shpjegim të thjeshtë: Fortino nuk i ka parë kurrë dorëshkrimet origjinale, por ka punuar me fotokopje, të cilat, sikurse dihet, nuk mund të japin elemente të sigurta për një interpretim të saktë filologjik, sidomos kur nga njëra fazë e punës në tjetrën kalon një kohë kaq e gjatë. Mund të sillja këtu shembuj të tjerë, por për arsye vendi po i le për një herë tjetër.

β.6: fl. 22v. Kemi të bëjmë me një poezi të shkurtër tetëvargëshe që pason në të njëjtën kolonë himnin që mbyll *Kalimerat* e mësipërme, por me të cilat nuk ka asnjë lidhje. Këtë e dëshmon përmbajtja, struktura formale (rimë e alternuar dhe rimë e puthur fundore, tipike për strofat tetëvargëshe) e së fundi shkrimi i ndryshëm i dorës. Me gjasa Santori do ta ketë shkruar si sprovë, bashkë me shënimet e tjera që gjenden pranë kolonës së djathtë të fletës, mes të cilave data <1869> e përsëritur disa herë, që përbën pa dyshim kufirin kohor *ante quem* të kësaj vepre.

β.7: Një fletë e vetme e shkruar në të dyja anët që Gangale e titulloi «Carmen Ad Doram Istriae a Francisco Antonio Santorio anno 1870 scriptum». Kemi të bëjmë me tekstin dygjuhësh shqip-italisht të lirikës që Dhimitër Kamarda botoi në pamfletin e famshëm kushtuar Dora D'Istrias¹⁹.

β.8: Dy fletë të palidhura, shkruar në të dyja anët, pjesërisht të grisura në mes. Përmbajnë grupe pak a shumë të rregullta vargësh, me ndërhyrje ndreqëse dhe shtesa autografe. Pas krahasimit me veprat e tjera të Santorit, këto të dhëna mund të marrin vlerë të veçantë.

III.5.γ Gangale e ka titulluar këtë fletore (me format të madh 19 × 24 cm.) «Laudes Mariae Virginis a Francisco Antonio Santorio redactae». Teksti shqip gjendet në kolonën A, krahas përkthimit italisht në kolonën B. Fletorja përmban gjithsej 14 fletë të panumërtuara, ndër të cilat vetëm 6v është e bardhë. Fleta e fundit, e palidhur, është shkruar në të dyja anët dhe është vendosur përkohësisht pas fletës së fundit të bardhë. Me siguri duhet vendosur në krye të fletores së cilës i mungon fillimi.

III.5.δ Ky është dorëshkrimi më i vëllimshëm i dosjes *Theca* III.5. Është një fletore me format të madh (19,2 × 23,8 cm.) së cilës Gangale i vuri titullin «Redactio altera Calimerae dierum

¹⁹ Shih Demetrio Camarda, *A Dora d'Istria, gli Albanesi. Canti pubblicati per cura di D. C.*, Livorno, Tip. G. Fabbreschi e C.. 1870.

Dominicarum et Quaresimae a F. A. Santorio redactae». Ky dorëshkrim përmban tekstet e botimit kritik plot mangësi dhe të meta që përgatiti Italo Costante Fortino²⁰, mbi të cilin do të rikthehemi më poshtë. Dsh. përmban 20 karta me gjithsej 40 fletë që mbajnë një numërtim arab progresiv autograf shkruar me penë. Vetëm një kartë është e bardhë (fl. 19-20). Në fl. 10, 13, 21 dhe 31 numërtimi ndërpritet, ndërsa për shkak të një gabimi të Santorit fl. 29 mban numrin 28. Pjesa që vijon është numërtuar saktë, përfshirë edhe dy fletët e bardha. Teksti shqip dhe ai italisht rrjedhin në dy kolona të çdo flete, përkatësisht djathtas dhe majtas. S'ka dyshim se kjo është kopja e pastër e variantit të parë që përmban dorëshkrimi III.5.β.5, por përbën edhe një fazë të mëtejshme të hartimit të veprës që nuk mund ta konsiderojmë të përfunduar së paku për tri arsye: së pari, sepse Santori nuk e kopjoi tekstin e *Kalimerës* së fundit që gjendet në fl. 22r të dsh. III.5.β.5 e për pasojë nuk kopjoi as *Kalimerën* <Imyn> që gjendet në fl. 22v; së dyti, sepse fleta e bardhë në mes të dorëshkrimit na bën të mendojmë se ishte lënë për t'u përdorur më pas; së fundi, sepse Santori nuk i përktheu në italisht tri *Kalimerat* e fundit, që ndryshe nga dymbëdhjetë të parat, na kanë mbërritur vetëm në variantin shqip. Në vijim po sjellim incipitet e *Kalimerave* bashkë me titujt origjinalë, duke filluar nga titulli autograf në shqip që Santori i vuri veprës: <Qalhimëre | Pry ty Dhielat e ty Qrësciomyvet | Rhufihen miràqulhit myy ty mbydëgn ty Zhottit Qrisct.>.

- fl. 1 <Qalhimèria | E ty Dhielys ty Paar | Scqretta,
Agkyrimi, Tantazona.>
- fl. 3 <Qalhimèria | E ty dhìelys ty dhit | Ndhyrtuòmia e
Qrisctit teq malhi ji Tabòrrit.>
- fl. 5 <Qalhimère je Tret | Vangkeli i sy Dhìelys ty tret.>
- fl. 7 <Qalhimère je IV.^v | Zhotti Qrisct nzier Scpirtin e
huoj. | Qa gny i verbyr e i vuvur e je sciyroòn>

²⁰ Shih Francesco Antonio Santori, *Le kalimere di Francesco Antonio Santori, Prolegomeni, trascrizione, apparato critico e concordanza*, Brenner, Cosenza 2004

- fl. 10 <Qalhimère je V.^{ty} | Jesu Qriscti sciyrôn gny i verbyr ciy quur lheu.>
- fl. 13 <Qalhimère je VI.^{ty} | Zhotti Qrisct Profetizzôn gny Gcrua Samaritàne.>
- fl. 16 <Qalhimère je VII.^{ty} | Zhotti Qrisct Ngkalyng Lhazharin i Betanies.>
- fl. 21 <Qalhimère je VIII.^{tyt} | Qriscti teq lhuzza e Kisciys ty Jerusalimit.>
- fl. 24 <Qalhimère je IX.^t | Qriscti Sciyròon gny ty Dhialòssur.>
- fl. 27 <Qalhimère je X.^t | Zhotti Qrisct ngkalyng ty birin i Kinturiònit.>
- fl. 29 <Qalhimère je XI.^t | Qologrèa Naimiòtte.>
- fl. 31 <Qalhimère je XII.^t | Zhotti Qrisct kyntròon gny monostròf Dhèti.>
- fl. 34 <Qalhimère je XIII.^t | Zhotti Qrisct ngkalyng ty birin e Rhegolit.>
- fl. 36 <Qalhimère je XIV.^t | Zhotti Qrisct sciyrôn ty Viehyrhyn e Piètyrit.>
- fl. 37 <Qalhimère je XV.^t | Zhotti Qrisct sciyroon gny Irdòpyq.>

2) Theca III.17

Edhe kjo *Theca*, së cilës Gangale i vuri emërtimin e përgjithshëm «A. Santori. Fylleta ty shprishura – A. Santorius. Folia disiecta»²¹, përbëhet nga disa fashikuj – kryesisht fletore të veçanta –, që po i përshekruajmë në vijim sipas të njëjtave kritere që përdorëm më lart.

III.17.α Sikurse na thotë edhe titulli i Gangales, «Folia disiecta. Scripsit Ant. Santori titulus: “Theossia e Jesu Chrishtit”. Repperi domi Radhae?», është fjala për një vepër me subjekt fetar që zë 8 fletë të lidhura bashkë, pa numërtim, shkruar nga të dyja anët (formati 15,5 × 22,2 cm.). Teksti është në shqip dhe vargjet janë ndarë në distikë të numërtuar nga

²¹ Giuseppe Gangale, *Verzeichnis*, cit., f. 606.

vetë autori. Ndrejjet brenda rreshtave janë të pakta. Duke u nisur nga ky fakt, si edhe nga shkrimi i rregullt mund të themi se kemi të bëjmë me një kopje të pastër të një varianti pararendës.

III.17.β Me titullin «Fragm. Lyricum Antonii Santorii. Domi poetae Radhae repertum», Gangale ka klasifikuar një fletore me format 16,5 × 23 cm. me gjithsej 7 karta, të shkruara nga të dyja anët përveç fletës së fundit që është e bardhë. Fletët mbajnë një numërtim joautograf me laps nga 1 deri në 7. Teksti i shkruar në dy kolona përbëhet nga pesë krijime poetike, katër nga të cilat mbajnë titullin <Chynocy> ndërsa njëra <Pirāti>. Do shënuar se kjo e fundit dhe ajo e nr. 4 shfaqen në dy variante të ndryshme. Në vijim po sjellim *incipit*et e teksteve sipas rendit origjinal:

- fl. 1 <Chynocy> <Cury lھےve, lھےve ti vasc.>
- fl. 2 <Chynocy> <Isc gny jym shum e mîry.>
- fl. 3 <Pirāti> <Armonissi Zhotti Ndhree.>
- fl. 4 <Chynocy> <Sckoi gny trim ca gny rugh.>
- fl. 6 <Chynocy> <My ju nissytin nynt trima.>
- fl. 7 <Piràta> <Armonissi Zhotti Ndhree.>
- fl. 7 <Chynocy> <Shcoi gny trim ca gny rug.>

III.17.γ «Rhapsodiarum libri tres, a Santorio collectarum. (Cave. Textus a Santorio plerunque [sic] manumissi sunt [sic])». Ky është titulli që i dha Gangale një radhe prej katër fletoresh të ndryshme. Para se të kalojmë në përshkrimin e hollësishëm të tyre, le të ndalemi në disa aspekte të përgjithshme, duke filluar nga shënimi me anë të të cilit Gangale kërkonte një shqyrtim të vëmendshëm të teksteve të fletores së parë.

γ.1 Fletore (formati 17,7 × 24,2 cm.) me gjithsej 16 fletë të numërtuara me shifra arabe autografe që nisin nga fl. 3. Në fakt dorëshkrimi i mungojnë së paku dy fletë. Kësaj fletoreje i referohej shënimi i Gangales, shtuar mes kllapash krahas titullit, i cili, pasi lexoi shënimin e mëposhtëm joautograf të fl. 18, vuri në dyshim autorësinë e tekstit:

<più che certo paiono di Michelangelo | De Rada – figlio del Girolamo>

Në të vërtetë autori i këtij teksti është Santori. Këtë e dëshmon qoftë grafia karakteristike e tij, qoftë disa tipare të veçanta fonetike, si p.sh. diftongu *-uo-*, tipik për gjuhën e Santorit. Me siguri këngët që përmban ky dorëshkrim nuk mund të konsiderohen popullore, e as mund të përfshihen në klasifikimin e përgjithshëm të Gangales. Këngët, që vijojnë njëra pas tjetrës pa ndërprerje, paraqesin një organizim formal të rregullt polistrofik e polimetrik që nuk ka të bëjë aspak me poezinë gojore tradicionale. Pra kemi të bëjmë me një vepër të pabotuar të Santorit që duhet analizuar e studiuar veçmas.

- γ.2 Fletore me format format $18 \times 24,5$ cm., me gjithsej 22 fl. të numërtuara me shifra arabe joautografe, shkruar me laps. Dorëshkrimi i mungojnë ballina dhe fletët e fundit: kjo kuptohet ngaqë teksti i fundit që përmban ndërpritet menjëherë. Dy veçanti të këtij dorëshkrimi na lejojnë të dallojmë dy faza të veçanta të punës së Santorit: Së pari, tekstet që rrjedhin në dy kolona dhe vetëm në shqip në pjesën e parë të dsh. (deri në fl. 14), nuk paraqesin ndërhyrje ndreqëse dhe duket se janë kopjuar nga variante pararendëse. Së dyti, tekstet e pjesës së dytë (duke nisur nga fl. 15), nga njëra anë, përmbajnë herë vetëm përkthimin italisht, herë edhe versionin shqip, nga ana tjetër paraqesin ndërhyrje të shumta ndreqëse, tipike të fazës së hartimit të tekstit (fshirje, rënie vizë, zëvendësime vargshesh etj.). Në vijim po sjellim *incipitet* e teksteve dhe titujt përkatës:

- | | |
|--|---|
| fl. 1 <Chynca Qusctyròre> | <Xajin buc di vylezsyrizs> |
| fl. 1 <Chynchy e 2> | <Byj chyscily Amibeccu> |
| fl. 2 <Chynchy e 3> | <Ngkusct vuu Maness'i mîry> |
| fl. 3 <Chynchy e 4> | <Prirej trimmi nga Jusctria> |
| fl. 4 <Chynchy e Pessym> | <Sckepti dieli mbi maglie> |
| fl. 5 <Chynchy e 6 ^m > | <Dit sckurturi muzsacki> |
| fl. 7 <Chynchy e 7 ^m > | <Nortessia Venetiote> |
| fl. 8 <Chynchy e 8> | <Scturi byndh scturi ndonat> |
| fl. 10 <Chynchy e 9> | <Scturi nymy Scanderbeccu> |
| fl. 11 <Chynchy e 10 ^m > | <Icu vascia e muori magliet> |
| fl. 12 <Chynchy e 11 ^m > | <Isc gny ditt e mieggulore> |
| fl. 13 <Jettryn mbryma curh ca jascti> | |
| fl. 14 <Nissu nissu via carre> | |
| fl. 15 <Traduzione> | <Giovin leggiadra che portava impressa> |

- fl. 19 <Chek e mâly me pyr ty tij>
 fl. 22 <Isc gny jym e fanisore>
 fl. 22 <Pokki placca tec ai varh>

γ.3 Fletore me format 20,6 × 25,4 cm., me gjithsej 140 fletë të numërtuara me shifra arabe autografe, herë-herë të përsëritura me laps nga tjetër dorë. Dorëshkrimi është i pajisur me ballinë dhe përmban dy krijime të veçanta të Santorit që Gangale nuk i ka vënë re.

γ.3a fl. 1-120. Përmban tekstet e këngëve dhe të rapsodive që Santori rishkroi me pak ndërhyrje ndreqëse, që shënojnë një fazë të re rikopjimi, duke ndjekur strukturën e përgjithshme që kemi përshkruar në fash. III.5.β.3. Tekstet shqip dhe italisht janë vendosur në dy kolona, të parat djathtas, të dytat majtas. Në vijim po sjellim *incipitet* e teksteve si edhe titujt përkatës në italisht:

- | | | |
|--------|--------------|---|
| fl. 1 | <Canto 1°> | <Quur jeesc'u i vogculhi0> |
| fl. 2 | <Canto II> | <Nussia marr ty holazhit>
<-----> |
| fl. 3 | <Canto III> | <Se ti vascyz e hadiäre>
<La giovane panettiera> |
| fl. 3 | <Canto IV> | <Quur lheve, lheve ti vasc>
<L'involumento sfortunato> |
| fl. 6 | <Canto V> | <Vasc ndhy sii dhî ciy ty gnoh>
<Il convegno amoroso> |
| fl. 7 | <Canto VI> | <Binej boor mbi boor>
<La giovane lavatrice e il vecchio prudente> |
| fl. 8 | <Canto VII> | <Vasc ndho dho ty dhùhiem>
<L'avvenamento> |
| fl. 10 | <Canto VIII> | <Byre gkyy te madhi, sciòq?>
<La rivista del vecchio Palicaro> |
| fl. 11 | <Canto IX> | <My scittòj ndhy gny scesc>
<Il cacciatore senza cacciagione> |
| fl. 12 | <Canto X> | <Anangas, vascia, ty zhoon:>
<L'infedeltà e la vendetta> |
| fl. 14 | <Canto XI> | <Dhiâlhi brîd ndhy dhèriet>
<L'odio e il miracolo> |
| fl. 16 | <Canto XII> | <Pienej aati bilhyrzhit>
<La lode a premio, il vaticinio a rim[a]> |
| fl. 18 | <Canto XIII> | <Kiparissi i Fughies> |

- fi. 19 <Canto XIV> <L'avventura d'amore>
<Alibequq i Rhumanis>
<La richiesta matrimoniale>
- fi. 20 <Canto XV> <Fyrscyglien dhi zhogca>
<Gli augelli parlanti>
- fi. 21 <Canto XVI> <Vemmi mottyriz ndhy qrua?>
<Le donzelle, la fontana, la paura, il grido>
- fi. 23 <Canto XVII> <Sa haraxi dhieli>
<L'apparecchio nuzziale, le ridde, le feste>
- fi. 24 <Canto XVIII> <Kiparissi i pari biir>
<Il trafugamento e l'augello testimone>
- fi. 25 <Canto XIX> <Trimi, biir ji Fughies>
<Il padiglione misterioso>
- fi. 26 <Canto XX> <Quur u pruartin Fatazhit>
<Gara delle Fate colle Streghe e il bacio prodigioso>
- fi. 28 <Canto XXI> <Se ti biir o biri j'ium>
<Il racconto e lo indovinamento>
- fi. 29 <Canto XXII> <Ajò zhogca pizzyvënd>
<L'Augello vaticinante, l'arancio misterioso, il Vecchio repubblicano>
- fi. 31 <Canto XXIII> <Zaqt dhuort i lastimiin>
<Il pretendente sdegnato, lo sposo felice>
- fi. 33 <Canto XXIV> <Byj qyscil zhogna Lheen>
<Il contratto e la Promessa della Dote>
- fi. 34 <Canto XXV> <Lhuonej vascia pry harèen>
<Il giuoco e la percossa>
- fi. 35 <Canto XXVI> <Venej kiparissi vet>
<Il Cacciatore e l'Augello vaticinante>
- fi. 36 <Canto XXVII> <Prirej trimi ji hejmùor>
<La malinconia e il merlo consolatore>
- fi. 37 <Canto XXVIII> <Dhalur dhieli mälhescit>
<L'abbigliamento degli sposi>
- fi. 40 <Canto XXIX> <Vasc sii zhezh e mes purtëq>
<La Peet dello sposalizio>
- fi. 41 <Canto XXX> <Ulhu nuse, lhumia nusse>
<Il canto Epitalamico>
- fi. 46 <Canto XXXI> <Qusc m'e byri triesyn>
<Il banchetto nuzziale>
- fi. 47 <Canto XXXII> <Mori vasc, je barda vasc>
<La nuova sposa contenta>

- fl. 47 <Canto XXXIII> <Ndhy gny dhit je vèrie>
<L'esperienza dei cuori al bagno
periglioso>
- fl. 49 <Canto XXXIV> <Ndhy podèen ty malhevet>
<Il castello di campagna e la
Ricamatrice>
- fl. 51 <Canto XXXV> <Vògcylihi biir i t'Ágatys>
<L'avventura del vecchio>
- fl. 53 <Canto XXXVI> <Vuri nqusct Kipariissi>
<La scommessa della corsa>
- fl. 56 <Canto XXXVII> <Frinej gn'ajyr, gn'ajyriθ>
<Il fanciullo desto dal sonno>
- fl. 57 <Canto XXXVIII> <Lhigkyròjin dhi qunàtta>
<Le millanterie di due cognate>
- fl. 58 <Canto XXXIX> <Skeppytòjin pry mbi dheet>
<I corsari e il ratto>
- fl. 62 <Canto XL> <Jqqu vàsca e mùori malhet>
<La schiava fuggitiva>
- fl. 63 <Canto XLI> <My udissi arminòi>
<La morte di Radavano>
- fl. 65 <Canto XLII> <Byri qysciil Alibeqqu>
<Il tentato rapimento e la morte>
- fl. 67 <Canto XLIII> <Vièen Marsi ? Miir se vièen>
<Il Presentimento>
- fl. 69 <Canto XLIV> <Teq ciùqqa ty gny raxhi>
<La morte di Deddi Scura>
- fl. 70 <Canto XLV> <Ajò zhogna Braðedrii>
<La previsione funesta>
- fl. 72 <Canto XLVI> <Ndhy dhi heer ty nàtties>
<Il guerriero moribondo>
- fl. 73 <Canto XLVII> <Sciòkkia e Dheddi Squrys>
<Le scolare e il Maestro>
- fl. 75 <Canto XLVIII> <Je kyntrùor e vettymezh>
<La vedovella sconsolata>
- fl. 77 <Canto XLIX> <Paraschej Qontescia Qontin>
<Il mostro della montagna>
- fl. 80 <Canto L> <GkerkgQandrèva zilhi òuhhej>
<L'uomo fatale e la giovane sventurata>
- fl. 83 <Canto LI> <Vàsca quur ciy zuu ty zhoon>
<Il prigioniero e la consorte>

- fl. 86 <Canto LII> <My kylòi gkumi>
<Il canto augurale e l'eroe dormiente>
- fl. 87 <Canto LIII> <Dhit scqùrturi Varrèz>
<La gravezza dell'imposta>
- fl. 89 <Canto LIV> <My qyntòj, qyntòj gny zhogc>
<Il riconoscimento>
- fl. 91 <Canto LV> <Ai Dhragùtti c'isc qussàr>
<Il corsaro e la tradita>
- fl. 94 <Canto LVI> <Vascia ciy ty dhàsciurin>
<Il ritorno del fidanzato>
- fl. 97 <Canto LVII> <Iqqu trimi qa sctypia>
<Il sospetto malpunito>
- fl. 99 <Canto LVIII> <Isc gny jým e fanymiir>
<La madre avventurosa e il matrimonio. Il
giuramento, la Resurrezione, Il viaggio mera-
viglioso, la morte del morto, la morte dei vivi>
- fl. 101 <Seconda Parte> <Pry ndhy hora t'arbyniis>
- fl. 102 <Terza Parte> <Quur ciy kiscia u mbulli>
- fl. 104 <Quarta Parte> <Tuqqe vattur ùdies>
- fl. 106 <Parte Quinta> <Garentina e vèttymezh>
- fl. 108 <Qynyqyzh> <Ndh'attò malhe ty Janninys>
<La tempesta terrestre>
- fl. 109 <Canto LIX> <Sa haràxi dhìeli>
<L'imprecazione>
- fl. 111 <Qynyqyzh e LX> <My gkymòì gkymòì malhi>
<La preda>
- fl. 112 <Qynyqy e LXI> <Lhussij vascia i parqalhèssij>
<La divisione>
- fl. 115 <Qynyqy LXII> <Rhij ty dhis gny biir zhotti>
<La malattia>
- fl. 117 <Qynyqy LXIII> <U martuan dhi gkitonne>
<L'invidia>
- fl. 118 <Qynyqy LXIV> <My rhyvòì gny vit i ryndh>
<La carestia>
- fl. 119 <Qynyqy LXVI> <Rhitti e mbessa t'ungcylhin>
<L'augurio>

Po ta shohim me kujdes, struktura e veprës, ndërhyrjet e pakta ndreqëse dhe gërshetimi organik i lëndës na bëjmë të mendojmë se kemi të bëjmë ne një variant përfundimtar a së paku të mëvonshëm ndaj variantit që pamë te *Theca* III.¹⁷

dhe *Theca* III.5.β.3. Mbetet ende për t'u shqyrtuar çështja e marrëdhënieve mes këtij varianti të rapsodive të Santorit dhe variantit që dëshmohet në tekstet e transkriptuara nga Francesco Altimari, të përkthyer nga Vincenzo Belmonte e të botuara në *Antologjinë e poezisë gojore arbëreshe* nga Anton N. Berisha²². Nga një krahasim i pjesshëm mes dy varianteve vihen re ndryshime të tilla që kërkojnë një studim të veçantë mbi marrëdhëniet genealogjike mes dorëshkrimeve përkatëse:

<Canto XXXVIII>	<i>Antologia</i>
Ligjërojin di kunata	Ligjërojin di kunata
Anamesa ca gjitone	Anamesa ca gjitone
Shoqa e Radavanit	Ti di rea t'Aghatës,
Shoqa e Qiparisit.	Të martuome ka tri vjet
Thoj e para Bardhadhrë:	Thoj e para Dhriza e Bardh
Jām e lūm mē u se ti:	Jam e mir mē u se ti:
Kām anaka t'arëtaç	Kam anaka t'arëtaç
Kural'e margaritare	Kurall'e margaritare

γ.3b: fl. 121-140. Përmban tekstin e një vepre me titullin autograf në shqip <Stòriezha>, titull që shoqërohet nga një lloj nëntitulli përmbledhës:

<Mbi za trimò00yra ty Pizzylhiis ty zilhyt mby piès ty sciyrbègnin po ty mundh gcadygnègnin ndhogn zop buq ty e haan, e ty mbiògnin barqun, siddò ty jeet, ty fritur nga nvidia, ty dhiègcur nga zhillia, e ty imòssur qa nzyrra veen si spiunyra qyttèj e attèj tue ruòitur me sii qykkii qusc qaa gkagkyy, e byyn faan e t'ij, e po e sciàgnin tue qyntùor armonisct si mulignet ciy biùognin, e tue rhimòssur si gaidiurt ndhy muòjin ty Majit o ty Øeristiut>

Teksti ndahet në shtatë pjesë, gjashtë prej të cilave me titullin <Stòriezha>, ndërsa e shtata është titulluar <Vaitim> <*Nenia*>. Nga grafia duket qartë se Santori jo vetëm që ka kopjuar dy

²² Është fjala për një grup prej 19 rapsodish, *Antologji e poezisë gojore arbëreshe*, Transkriptimin e teksteve Francesco Altimari, Përktheu dhe rishikoi përkthimet në italisht Vincenzo Belmonte, Rubbettino, Soveria Mannelli, 1998.

versione – njërin shqip në kolonën e majtë e tjetrin italisht në të djathtën –, por ka ndërhyrë me ndreqje brenda rreshtit dhe mes rreshtash vetëm në versionin italisht. Këtej rrjedh, së pari, se dy tekstet janë kopjuar nga variante të tjera dhe, së dyti, nisur nga ndërhyrjet ndreqëse mbi përkthimin italisht, se vepra duhej t'i nënshtrohej një faze të mëtejme rishikimi. Sa i përket këtij aspekti të fundit, duhet shënuar se pjesa e fundit e tekstit ndërpritet papritur, a thua se Santori do të ketë qenë i detyruar ta vijonte kopjimin në një fletore tjetër që nuk gjendet në fondin *Albansk Samling*.

3) Theca V.58

Titulli që mban kjo *Theca*, «Melodrama t'arbyreshy ty shkruary ka Ntoni i Santorit. – Antonii Santorii melodrama Arberiscum»²³, përkon me përmbajtjen e fashikullit me veprën që Santori e titulloi <Melodrama Alhbrësh>. Fletorja me format 18,5 × 26 cm. numëron gjithsej 22 fl. Në faqet *recto* të fl. 8-22 që kanë mbetur të bardha, do të vijonte përkthimi italisht, që zë faqet *recto* të fletëve të para e ndërpritet në rreshtin e dytë të fl. 7r. Për të dhëna më të hollësishme të shihet punimi i lartpërmendur nga Mimma Capaci.

4.– Një variant i veprës *Soldato albanese dhe disa hipoteza mbi procesin e shkrimit të veprave të Santorit*

Dega e dytë e odisesë së veprave të Santorit paraqitet më e ndërlikuar dhe më problematike sesa ajo që ruhet në fondin danez. Duke qenë “private”, ajo përjashton mundësinë e shqyrtimit dhe të krahasimit të dorëshkrimeve, qoftë edhe për të kuptuar se sa vepra të Santorit nuk janë sot në dispozicion të studiuesve. Me siguri mund të themi se një numër i konsiderueshëm i dorëshkrimeve të Santorit sot është në dorë të privatëve²⁴. Disa nga këto

²³ Giuseppe Gangale, *Verzeichnis*, cit., f. 614.

²⁴ I tillë është rasti i dorëshkrimeve me dramën *Emira*. Me sa na thotë Gradilone, kjo vepër e Santorit, përveç se nga variantet e shtypura, na dëshmohej nga dy variante

dorëshkrime mund të përmbajnë kopje të vetme veprash të panjohura. I tillë ishte p.sh. rasti i *Satirave*²⁵. Të tjerat, që dëshmojnë variante veprash të njohura, janë të domosdoshme për të rindërtuar historinë e shkrimit të atyre veprave.

Rasti i dorëshkrimit që gjetëm në arkivin privat të Zef Skiroit përbën një shembull paradigmatic për të shpjeguar më tej e madh që i shkaktohet historisë së letërsisë arbëreshe dhe në veçanti veprës së Santorit. Është fjala për kopjen autografe të romanit *Albenzjo Toarson*,²⁶ që njihet ndryshe me titullin *Il soldato italiano*, nga i cili njiheshin vetëm variantet autografe që ruhen në Bibliotekën e qytetit të Kozencës.

Fletorja me format 20 × 30 cm. përmban gjithsej 152 fletë me numërtim progresiv arab shkruar në *recto* dhe në *verso*, përveç ballinës dhe fl. 148-152 që nuk kanë numër. Fleta 152 është e bardhë. Vepra është pa dyshim autografe e Santorit.

Mbi ballinë është shkruar titulli i plotë i veprës:

dorëshkrim: i pari është i paplotë («Ho preso visione di un *autografo* degli atti I – 4 scene, pp. 20 più il frontespizio – e V – 5 scene, pp. 9 →»), ndërsa për të dytin ka vetëm një dëshmi gojore («Mi è stato riferito che esiste un autografo integro di tutto il dramma, ma io non ho potuto prenderne visione»): Giuseppe Gradilone, «Prolegomeni» në Francesco Antonio Santori, *Panaini e Dellja - Fëmija pushterjote*, cit., f. 16 shën. 16. Është e qartë se, sikur të ekzistojë vërtet ky dorëshkrim i dytë – gjë që, edhe në dritën e asaj çka thotë Alberto Straticò në veprën *Manuale di letteratura albanese*, Hoepli, Milano, 1896, f. 235, shën. 1, nuk mund të përjashtohet – atëherë do të duhej rishikuar nga e para historia e shkrimit të veprës.

²⁵ Shih Françesk Anton Santori, «Satirat» (transliteruar dhe pajisur me shënime nga Karmell Kandreva dhe Gjovalin Shkurtaç), në *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë, 1982, f. 173-208. Dorëshkrimin me *Satirat* në vitin 1979 pronari i tij Carmelo Candreva ia dhuroi Institutit të Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Nga përshkrimi që i ka bërë Gjovalin Shkurtaç, autorësia e dorëshkrimit që është pa titull dhe anonim, i duhet njohur Santorit mbi bazën e grafisë, të alfabetit dhe disa tipareve të tjera tekstore (*po aty*, f. 174). Gjithnjë sipas këtij studiuesi, vepra «është e papërfunduar, ndonëse dorëshkrimi (fletorja) përfundon dhe nuk lë gjurmë që të tregojnë vijim» (*po aty*, f. 175). Në vitin 1998 vepra është ribotuar nga përgatitësit pa asnjë ndryshim thelbësor: shih Françesk Anton Santori, «Satirat» përgatitur nga Karmell Kandreva dhe Gjovalin Shkurtaç, Dituria, Tiranë, 1998.

²⁶ Çështja e mbiemrit të personazhit që shërben si titull për veprën është zgjidhur nga i ndjeri prof. Francesco Solano në një konferencë të vitit 1984. Në fakt

<Albenzio Toarson | Il Recluta Albanese pei Musulmani| Romanzetto | Civico Morale | Rilevato con larga parafrasi, sur una canzone delle molte | popolari antiche dagli Albanesi conservate tuttavia, | per opera della vocal Tradizione e del canto; de' qua|li servonsi a trasmetterle di generazione in genera|zione alla loro prosterità>.

Në anën *recto* të ballinës sillet një <Tavola | de' Personaggi>. Teksti në italisht ndahet në 24 pjesë a krerë, ndërsa në fl. 151 sillet kjo pasqyrë e lëndës (<Indice | dei | Capitoli>):

- fl. 1 <I Il villaggio di Fulgaria>
- fl. 9 <II La trappola degli scolari>
- fl. 13 <III La bottega di Maestro Gino>
- fl. 21 <IV Il racconto di Stigonao>
- fl. 29 <V Lo scioglimento della conversazione>
- fl. 33 <VI L'abitazione di Stigonao Olmadel e Naresite Orvatin>
- fl. 39 <VII Il Diritto, la Ingiustizia e la Preghiera>
- fl. 44 <VIII La Famiglia desolata>
- fl. 49 <IX La morte del Cristiano>
- fl. 57 <X La Suocera Ingelosita>
- fl. 58 <XI Il Firmano della Coscrizione>
- fl. 64 <XII Il Pane dato per Focaccia>
- fl. 70 <XIII L'Avventura ridicola>
- fl. 77 <XIV La Cena della Famiglia Cristiana>
- fl. 82 <XV La Fontana di Fulgaria>
- fl. 87 <XVI Gli ordini per la partenza>
- fl. 90 <XVII La scoperta odiosa e la Divisione>
- fl. 101 <XVIII Il contento e l'amarrezza>
- fl. 111 <XIX La confessione di Naresite>
- fl. 119 <XX La Soggiunta>
- fl. 124 <XXI La Vita di Sterea nella Casa Paterna>
- fl. 133 <XXII Il Ritorno>
- fl. 140 <XXIII La Giustizia, La Vendetta e La Catastrofe>
- fl. 147 <XXIV La Canzone di Documento>

Vetëm kreu i fundit, me titull <Lo schiarimento>, është shkruar në dy gjuhë (shqip në kolonën e majtë dhe italisht në të djathtë) dhe riprodhon tekstin e këngës “popullore” nga e cila, sipas autorit, mori shkas vepra.

Teksti paraqet ndërhyrje ndreqëse autografe që janë përqendruar kryesisht në fletët e para të dorëshkrimit: fshirjet, ndreqjet, zëvendësimet dhe plotësimet e shumta me natyrë stilistike mund të shpjegohen në dy mënyra: ose si punë përgatitore për një fazë të mëtejshme përpunimi të tekstit, ose si përsosje e një teksti tashmë të përfunduar.

Vërtetimi i njëres a tjetres hipotezë bëhet i mundur vetëm pas krahasimit të këtij dorëshkrimi me dy variantet me titullin *// soldato albanese* që ruhen në Bibliotekën e qytetit të Kozencës. Në fakt s'ka dyshim se kopja e gjetur në Palermo, me gjithë ndryshimet e ndjeshme sidomos në strukturën e titujve të brendshëm, duhet lidhur me variantet që përshkroi Giuseppe Gradilone²⁷ në hullinë e të dhënave që mbledhi për punimin e diplomës Aurelia Passaniti²⁸.

Dy dorëshkrimet autografe të Kozencës, në mungesë të variantit të Palermos, Gradilone i konsideroi të lidhura drejtpërdrejt mes tyre. Kështu studiuesi arbëresh «pa asnjë ngurrim», e do të thosha me të drejtë, e quajti njërin nga dorëshkrimet që këtu po e shënojmë me siglën α , «kronologjikisht të parin për shkak të shtjellimit më të ngushtë të subjektit, si edhe për shkak të një përpunimi më të paktë»²⁹. Rrjedhimisht dorëshkrimi i dytë që po e shënojmë me siglën β mbetej të ishte varianti «përfundimtar», pasi «lënda në këtë variant të dytë është zgjeruar ...»³⁰.

Meqenëse ky variant i fundit paraqet bashkëpërkime të shumta me variantin e Palermos që po e shënojmë me siglën γ , duhet


“TOARSON” s’është gjë tjetër veçse anagrami i mbiemrit “SANTORO”. Është një mënyrë kodifikimi për emrat e personazheve që kanë ekzistuar vërtet. Falënderoj Vincenc Belmonten që ma komunikoi këtë të dhënë.

²⁷ Shih Giuseppe Gradilone, “Francesco Antonio Santori. Un romantico fra tradizione e realismo”, cit., f. 7-8, shën. 15.

²⁸ Shih Aurelia Passaniti, *Francesco Antonio Santori e le sue opere in prosa italiana*, Università degli Studi di Roma, a. a. 1965-66.

²⁹ Shih Giuseppe Gradilone, “Francesco Antonio Santori. Un romantico fra tradizione e realismo”, cit., f. 7, shën. 15.

³⁰ *Po aly*, f. 8, shën. 15.





Arkivi privat i Zef Skiroit

Gr. Φ Dorëshkrime të veprave të autorëve të tjerë arbëresbë e shqiptarë
fash. nr. 4, ballina

shtruar problemi i lidhjeve gjenealogjike mes varianteve. Me fjalë të tjera, propozimi i Gradilonës:



që u bë kur njiheshin vetëm dy variante, duhet rishikuar dhe plotësuar me një nga dy alternativat e mëposhtme:



alternativa këto që përputhen plotësisht me dy hipotezat që hodhëm më lart mbi fazat e shkrimit të veprave të Santorit. Tashmë këto faza mund t'i përshkruajmë në këtë mënyrë:

faza I: skica –faza II: shkrimi në dorë të parë –faza III: shkrimi përfundimtar.

Natyrisht që kjo hipotezë mund të vërtetohet përfundimisht vetëm pasi të njihen e të studiohen edhe dorëshkrimet që sot janë në dorë të privatëve. Me aq sa dimë deri më tash nga veprat e botuara të Santorit, mund të themi se ato na kanë mbërritur kryesisht në tri variante dorëshkrim. Në ato raste kur kemi vetëm dy variante të njohura, këto shoqërohen nga ndjesia e fortë e ekzistencës së një varianti të tretë që nuk na ka mbërritur ose që nuk e kemi në dispozicion. Në grupin e parë bëjnë pjesë p.sh. tri dorëshkrimet e “romanit” *Kolluqi e Sorofina*, dy prej të cilave ruhen në Bibliotekën e qytetit të Kozencës, ndërsa i treti ruhet në arkivin privat të të ndjerit profesor Giuseppe Ferrari³¹. Në grupin e dytë bëjnë pjesë dorëshkrimet autografe të romane-

³¹ Shih Francesco Antonio Santori, *Tre novelle*, cit., f. 43.

ve që botuan Gradilone (*Panaini e Dellja dhe Fëmija pushterjote*)³² dhe Fortino (*Brisandi, Lletixja e Ulladbeni*)³³ dhe *Fillaredhi, Zarija e Millja*³⁴). Në këtë grup duhet të futim edhe dorëshkrimet me *Kalimerat*, dorëshkrimet që përmbajnë të ashtuquajturat “rapsodi” të Santorit dhe së fundi dorëshkrimet e lartpërmendura me dy variantet autografe të dramës *Emira*.

Nëse kërkimet e ardhshme do të konfirmojnë këtë hipotezë pune, atëherë do të dalë nevoja e rishikimit të kritereve të përdorura deri më sot. Me fjalë të tjera do të na duhet të përballemi me çështjen e avanteksteve³⁵, pra me nevojën e shqyrtimit e ndoshta të botimit të varianteve përgatitore, të pjesshme, të paplota, që deri më sot janë sakrifikuar në emër të përparësisë së varianteve të ashtuquajtura “përfundimtare”.

Vlera dhe dobia e varianteve që përmbajnë përpunimet e para të një vepre në funksion të përgatitjes së botimit kritik tashmë dëshmuar bindshëm me botimin e *këngëve të paramilosaos* të Jeronim De Radës³⁶ dhe të *Rapsodive Shqiptare* të Zef Skiroit³⁷. Një qasje e tillë metodologjike duhet përshtatur edhe për botimin kritik të veprës së plotë të Santorit. Në këtë mënyrë do të mund të shihet vepra letrare ashtu siç është në të vërtetë, pra si rezultat i një procesi hartimi të gjatë e të ndërlkuar.

³² Shih Giuseppe Gradilone, “Prolegomeni” në Francesco Antonio Santori, *Panaini e Dellja - Fëmija pushterjote*, cit., f. 17-20.


³³ Shih Francesco Antonio Santori, *Brisandi Lletixja e Ulladbeni*, cit., f. 13, shën. 1.

³⁴ Shih Francesco Antonio Santori, *Tre novelle*, cit., f. 43.

³⁵ Mbi avantekstin shih qoftë rezervat e Cesare Segre-së, *Avviamento all'analisi del testo letterario*, Einaudi, Torino, 1985, f. 79-85 qoftë konsideratat pozitive të Alfredo Stussi-t, *Introduzione agli studi di filologia italiana*, il Mulino, Bologna, 2007 (nuova edizione), f. 158-160.

³⁶ Girolamo De Rada, *I Canti Premilosaici. Edizione critica e traduzione italiana*, edizione critica a cura di Francesco Altimari, Classici della letteratura arbëreshe, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 1998, ribotuar në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, Vol. I, *I Canti Premilosaici (1833-1835)*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, Classici della letteratura arbëreshe, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2005, f. 37-39.

³⁷ Giuseppe Schirò, *Opere*, a cura di Matteo Mandalà, vol. I: *Kroja, Rapsodie Albanesi*, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 1998, f. LXXIII-XCV dhe f. 189-237.



Arkivi privat i Zef Skiroit

Gr. Φ Dorëshkrime të veprave të autorëve të tjerë arbëreshë e shqiptarë

fash. nr. 4, f. 147